



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2019:267175
Datë: 08.03.2021
Numri i dokumentit: 01573350

P.nr.1023/2019

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN-Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtarin e vetëm gjykues Rilind Sermaxhaj, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Eronita Llapashtica, në çështjen penale kundër të pandehurit A. F nga Gjilani, për shkak të veprës penale vjedhje në tentativë nga neni 325 paragrafi 1 lidhur me nenin 28 të KPRK-ës, duke vepruar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan me numër PP.II.nr.1813/2019, të datës 15.11.2019, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor, me datë 22.02.2021, mori dhe publikisht shpalli ndërsa me datën 08.03.2021 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri A. F, nga babai R... dhe nëna H..., e lindur G..., i lindur me datë ... në Gjilan, ku edhe jeton në rrugën "...", numër 9, i pa martuar, i papunësuar, ka të kryer shkollën fe mesme, i gjendjes së varfër ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës dhe

ËSHTË FAJTOR

Sepse me datë 02.11.2019, rreth orës 18:00 h, në rrugën "...", në Gjilan, saktësisht tek Fabrika e Radiatorëve, me qëllim të përvetësimit të kundërligjshëm pasuror për vete, me qëllim të vjedhjes ka hyrë në kuzhinën e fabrikës dhe pasi është hetuar nga punëtorët e kësaj kuzhine, tenton të ikë dhe në oborrin e fabrikës kapet nga rojet me ç' rast edhe vepra penale mbetet në tentativë.

-Me çka ka kryer veprën penale vjedhje në tentativë nga neni 325 paragrafi 1 lidhur me nenin 28 të KPRK-ës.

Andaj, gjykata në bazë të nenit 4,38,39,46,47,48,49,69,70,71 dhe 72 të KPRK-ës dhe neneve 248 e 365 të KPP-ës, të pandehurin A. F:

E GJYKON

Me dënim gjobë në shumë prej 400 € (katërqind euro) dhe dënim me burgim në kohëzgjatje prej 140 (njëqindëdyzet), të cilat dënime nuk do të ekzekutohen nëse i pandehuri në periudhën verifikuese prej 1 (një) viti nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale.

E dëmtuara Fabrika e Radiatorëve në Gjilan, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest të rregullt juridiko-civil.

REFUZOHET propozimi i prokurorit të shtetit për shqiptimin e masës së trajtimit me anë të rehabilitimit të detyrueshëm për personat e varur nga droga dhe alkooli meqenëse të pandehurit të lartcekur me aktgjykimin e kësaj gjykate P.nr.832/2020, të datës 28.01.2021, tanimë i është shqiptuar një masë e tillë dhe se shqiptimi i një masë të re dhe të njejtë nuk do të kishte kurrfarë efekti në përmirësimin e gjendjes së tij.

Obligohet i pandehuri që të paguaj paushallin gjyqësor në shumën prej 50 € (pesëdhjetë euro) si dhe shumën prej 30 € (tridhjetë euro) për kompensimin e viktimave të krimit të gjitha këto në afat prej 15 ditëve pasi që ky aktgjykim të merr formën e prerë, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

ARSYETIM

1.Rrjedha e çështjes

Prokuroria Themelore në Gjilan, Departamenti i Përgjithshëm, me datë 18.11.2019, ka ngritur aktakuzën me numër PP.II.nr.15.11.2019, kundër të pandehurit Asdren Fetahu nga Gjilani, për shkak të veprës penale vjedhje në tentativë nga neni 325 paragrafi 1 lidhur me nenin 28 të KPRK-ës.

Më datë 18.02.2021, në këtë gjykatë është mbajtur seanca e shqyrtimit gjyqësor në të cilën ishin prezent prokurori i shtetit, i pandehuri me mbrojtësen e saj avokaten Lirie Kovani si dhe eksperti psikiatër Dr. Afrim Cana. Në këtë seancë eksperti psikiatër ka deklaruar se i njëjti është i aftë që ta përcjell gjykimin ndërsa sa i përket gjendjes së tij mendore ka deklaruar se kemi të bëjmë me një individ i cili për shkak të abuzimit me substancave psikoaktive për një periudhë relativisht të gjatë kohore tani më është person i varur nga këto substanca dhe ka propozuar që të njëjtit ti ofrohet mundësia që të trajtohet, pas këtyre deklarimeve seanca e shqyrtimit gjyqësor ka vazhduar në rrjedhën normale të saj me ç'rast pas leximit të aktakuzës nga ana e prokurorit të shtetit i pandehuri i lartcekur ka deklaruar se e ka kuptuar në tërësi aktakuzën dhe veprën penale për të cilën akuzohen dhe se e pranon fajësinë për kryerjen e saj me ç'rast gjykata pas dëgjimit të palëve dhe në pajtim me nenin 326 të KPP-ës, ka marrë aktvendim me të cilin ka pranuar pranimin fajësisë nga ana e të pandehurit dhe pastaj palët kanë dhënë fjalët e tyre përfundimtare.

Prokurori i shtetit në fjalën përfundimtare ka deklaruar se meqenëse i pandehuri ka pranuar fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë dhe se ky pranim i fajësisë është i mbështetur në provat tjera materiale bashkangjitur aktit akuzues, fakte këto dhe prova në baze të të cilave në mënyrë të pa kontestueshme argumentohet fakti se tani i pandehuri ka kryer veprën penale të përshkruar si në dispozitiv të kësaj aktakuze andaj ka kërkuar nga gjykata që komfor dispozitive ligjore të njëjtin ta shpall fajtor dhe ta dënoj sipas ligjit ndërsa sa i përket caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit i ka propozuar gjykatës që ti merr parasysh rrethanat lehtësuese dhe rënduese me qëllim që dënimi të jetë në proporcion me shkallën e përgjegjësisë së të pandehurit si dhe rrezikshmërinë e veprës penale, po ashtu ka propozuar që krahas dënimit të pandehurit ti shqiptohet edhe masa e trajtimit me anë të rehabilitimit të detyrueshëm për personat e varur nga droga dhe alkooli siç tha edhe eksperti psikiatër me arsyetimin se kjo e tëra është në dobi edhe të vetë pandehurit dhe evitimit të kryerjes së veprave të tjera penale.

Mbrojtësja e të pandehurit A. F, avokatja Lirije Kovani në fjalën e saj përfundimtare ka deklaruar se: meqenëse i pandehuri A. F e ka pranuar fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë atëherë mbrojtja nuk e kundërshton masën e cila iu është shqiptuar me aktgjykimin P.nr. 832/20 duke shtuar se masa e cila i është shqiptuar më herët është edhe në interes të mbrojturit të saj si dhe nuk e kundërshton konstatimin e mjekut psikiatër Dr. Afrim Cana duke shtuar se masa e cila është propozuar është në proporcion me peshën e veprës penale dhe e njëjta shpreson se do të ndikojë në shëndetin mendor të të pandehurit, ndërsa sa i përket dënimit ka kërkuar nga gjykata që ti ketë parasysh të gjitha rrethanat lehtësues të parapara në ligj dhe të merr parasysh shëndetin e të pandehurit, gjendjen ekonomike të tij, moshën e tij të re, pranimin e fajësisë dhe ti shqiptojë një dënim më të favorshëm me të cili do të arrihet edhe efekti i dënimit.

I pandehuri A. F në fjalën përfundimtare ka deklaruar se e mbështet në tërësi fjalën përfundimtare të mbrojtëses së tij duke shtuar se pendohet për veprimet e tij, i kërkon falje të dëmtuarës për sjelljet e tija dhe se një gjë të tillë e kishte bërë edhe më parë, premton që në të ardhmen nuk do të përsëris vepra të tilla penale si dhe ka premtuar se do ti përmbahet masës së propozuar andaj edhe ka kërkuar nga gjykata që ti shqiptoj një dënim sa më të butë.

2.Vlerësimi i pranimit të fajësisë

Gjykata pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar në të cilin kanë qenë palët e lartcekura pas dëgjimit të palëve ka marrë aktvendim me të cilin ka pranuar pranimin e fajësisë e të pandehurit A. F ngase ka konstatuar se janë plotësuar gjitha kushtet ligjore për një gjë të tillë si në kuptim të nenit 326 lidhur me nenin 248 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1, 1.2, 1.3 dhe 1.4 të KPRK-së. Në këtë aspekt gjykata ka konstatuar se i pandehuri e ka kuptuar drejtë natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht nga ana e tij pas konsultimeve të mjaftueshme me mbrojtësen e tij, se i pandehuri nuk kanë qenë i detyruar ose i shtrënguar në asnjë mënyrë që të pranojë fajësinë, se pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes të cilat i përmban aktakuza siç janë: deklarata e të pandehurit A. F, deklarata e dëshmitarit Xh. O, raporti i oficerit si dhe shkresat e tjera të lëndës po ashtu me rastin e pranimit të fajësisë nga ana e të pandehurit gjykata gjeti se aktakuza lëndore nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

3.Gjendja faktike e vërtetuar

Duke u bazuar në të lartcekurat, gjykata vërtetoi këtë gjendje faktike: i pandehuri A. F dhe nga Gjilani, ka kryer veprën penale vjedhje në tentativë nga neni 313 paragrafi 1 lidhur me nenin 28 të KPRK-ës, si në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

4.Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit

Gjykata me rastin e matjes së dënimit ka vlerësuar që të pandehurit duhet ti shqiptohen dënimet si në dispozitiv të këtij aktgjykimi ngase duke i marrë parasysh të gjitha rrethanat dhe provat të cilat gjinden në shkresat e lëndës, ky dënim do të jetë i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale, sjelljen dhe rrethanat e kryesit si dhe përgjegjësinë penale të tij, gjykata me rastin e matjes së dënimit pati parasysh rregullat e përgjithshme për matjen e dënimit si në kuptim të nenit 69 të KPRK-ës po ashtu gjykata pati parasysh edhe rregullat e përgjithshme të cilat ndikojnë në zbutjen apo ashpërsimin e dënimit si në kuptim të nenit 70 të KPRK-ës ashtu që si rrethanë lehtësuese për të pandehurin mori faktin se i njejtë e

ka pranuar fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë, i njejtë është penduar dhe ka shfaqur keqardhje për veprimet e tija, i ka kërkuar falje të dëmtuarës për këto veprime duke shtuar se këto veprime i ka bërë nën ndikimin e substancave narkotike, faktin se i njejtë ka premtuar që në të ardhmen nuk do të kryej vepra të tilla dhe as vepra të tjera penale ndërsa si rrethanë rënduese për të pandehurit gjykata mori shkallën e lartë të dashjes të shfaqur nga ana e tij meqenëse nga përshkrimi faktik si dhe provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës del se i pandehuri këtë vepër penale e ka kryer me dashje dhe me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm pasuror për vete.

Gjithashtu duke u bazuar në të lartcekurat dhe në kuptim të nenit 73 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të KPRK-ës gjykata të pandehurit i shqiptoj dënimin brenda kufijve të paraparë ligjor të paraparë si në nenin 74 të KPRK-ës, gjithnjë duke konsideruar se me dënimet e shqiptuara ndaj të pandehurit mund të arrihen qëllimet e dënimit si në kuptim të nenit 38 të KPRK-ës të cilat konsistojnë në parandalimin e të pandehurit nga kryerja e veprave penale dhe rehabilitimin e tyre, parandalimin e personave të tjerë nga kryerja e veprave penale, shprehjen e gjykimit shoqëror për veprën penale dhe ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

5.Vendimi lidhur me kërkesën pasurore juridike.

Sa i përket kërkesës pasurore juridike, gjykata në bazë të nenit 463 paragrafi 1 dhe 2 të KPP-ës për realizimin e kërkesës pasurore juridike, të dëmtuarën e udhëzoi në kontest të rregullt juridiko civil.

6.Vendimi për refuzimin e propozimit për shqiptimin e masës së trajtimit të detyrueshëm psikiatrik me ndalim për personat e varur nga droga dhe alkooli.

Sa i përket propozimit të prokurorit të shtetit që të pandehurit krahas dënimit të shqiptohet edhe masa e trajtimit me anë të rehabilitimit të detyrueshëm për personat e varur nga droga dhe alkooli gjykata duke vepruar sipas detyrës zyrtare erdhi në përfundim se një propozim i tillë duhet të refuzohet meqenëse të pandehurit të lartcekur sipas aktgjykimit të kësaj gjykate me numër P.nr.832/2020, të datës 28.01.2021, tanimë i është shqiptuar një masë e tillë dhe se shqiptimi i një masë të re dhe të njejtë nuk do të kishte kurrfarë efekti në përmirësimin e gjendjes së tij.

7.Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale

Duke pasur parasysh natyrën e kësaj çështje penale dhe gjendjen financiare të të pandehurit, gjykata duke u bazuar në nenin 451 paragrafi 1 të KPP-së, ka vendosur që të pandehurin ta detyrojë që të paguaj paushallin gjyqësor në shumë prej nga 50 € (pesëdhjetë euro) si dhe shumë prej nga 30 € (tridhjetë euro) për kompensimin e viktimave të krimit, të gjitha këto në afat prej 15 ditëve nga dita kur ky aktgjykim të merr formën e prerë.

Andaj duke u bazuar në të lartcekura gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN

Departamenti i Përgjithshëm

P.nr.1023/2019, me datë 08.03.2021

Zyrtare ligjore,
Eronita Llapashtica

Gjyqtari i vetëm gjykues,
Rilind Sermaxhaj

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e Apelit në

Numri i lëndës: 2019:267175
Datë: 08.03.2021
Numri i dokumentit: 01573350

Prishtinë, në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit të të njëjtit. Ankesa në kopje të mjaftueshme i paraqitet kësaj Gjykate Themelore.